



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 65

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ KRYETARIT TË BASHKISË DHE PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË PATOS, PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 22 Shkurt 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

- SUBJEKT:** Zj. Rajmonda Balilaj, kryetar i bashkisë Patos
Z. Shkëlqim Beqiraj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për bashkinë Patos
- OBJEKT:** Shqyrtim administrativ ndaj kryetarit të bashkisë dhe personit përgjegjës të bashkisë Prrenjas, për raportimin e veprimtarive publike
- BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 6.2.2023, në adresën postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 2 (dy) veprimtarive publike nga ana e bashkisë Patos.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

1. Nëpërmjet raportit të gjetjeve të datës 6.2.2023, ku pretendohet se: *“Referuar ndalimeve të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, ndër të*

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 65

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj kryetares së bashkisë dhe personit përgjegjës të bashkisë Patos, për raportimin e veprimtarive publike”

tjera, ndalohet edhe shperndarja e titujve të ndryshëm të pronësisë tek qytetarët, konkretisht neni 3, pika 1.3 shkronja "a". Në faqen "Facebook" të bashkisë Patos, është publikuar nje postim në përshkrimin e të cilit citohet: "Familja Abazi me shtëpi të re! Kryebashkiakja Balilaj i ka dorëzuar çelësat e shtëpisë së re Viktorit, duke realizuar kështu ëndrrën e 5 anëtarëve të kësaj familje me probleme sociale. Ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, nga institucioni organizator".

Bashkëlidhur është dërguar prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=541514934674510&set=pcb.541515154674488>

2. "Familja Abazi me shtëpi të re. I dorëzuar çelësat Viktorit, duke realizuar ëndrrën e 5 anëtarëve të kësaj familje me probleme sociale".

Bashkëlidhur është dërguar prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=890621332355159&set=pcb.890621545688471>

Bazuar në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht denoncimin, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur 2 (dy) indicie nëpërmjet provave link të ndryshme, të cilat në thelb kanë të bëjnë me të njëjtin aktivitet publik.

Objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në këto kushte, në mbështetje të nenit 65, shkronja "ç", të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", vendos të shqyrtoj së bashku këto indicie.

Në vijim të procedurës administrative, më datë 9.2.2023, kam kërkuar informacion në bashkinë Patos në adresën elektronike, në lidhje me veprimtarinë publike të raportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (indicia e parë).

Më datë 9.2.2023, ora 1:35 PM, bashkia Patos, ndër të tjera bën me dije se: "Aktiviteti është zhvilluar në datën 11 Janar 2023, ora 10:00, organizuar nga bashkia Patos, me tematikë "Dhënia e banesës sociale familjeve në nevojë", me pjesëmarrjen e kryetares së bashkisë dhe drejtorin e Agjencisë së Shërbimeve Publike. Ky aktivitet është realizuar përpara datës 13 Janar 2023, siç e parashikon vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator.

Në lidhje me indicien e dytë, kam kërkuar informacion nga bashkia Patos, nëpërmjet shkresës nr. 761 prot., datë 10.2.2023, në lidhje me aktivitetin, që sipas indicies së marrë, mund të jetë e veprimtari e ndaluar.

Nëpërmjet shkresës nr. 436/1 prot., datë 15.2.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 761/1 prot., datë 17.2.2023, bashkia Patos informon se *“Aktiviteti është kryer më datë 11.1.2023, periudhë e cila del jashtë rregullimeve të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, pasi detyrimi për raportim dhe ndalimi për zhvillim i disa veprimtarive të caktuara niste më datë 13.1.2023.”*

Pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se veprimtaria publike e zhvilluar nga bashkia Patos nuk përbën shkelje sipas parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Veprimtaria publike është kryer para datës 13.1.2023, datë e cila korrespondon me nisjen e afateve ligjore për detyrimin për raportim të veprimtarive publike dhe ndalimin e përdorimit të fondeve publike.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S :

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj, zj. Rajmonda Balilaj, kryetar i bashkisë Patos.
2. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Shkëlqim Beqiraj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Patos.
3. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
4. Tërheqje vëmendje ndaj bashkisë Patos, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
5. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI